



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0054399-3/25, dt. 11.09.2025

Mitrovicë

Bazuar në nenet 11, 12, paragrafi 2, pika (d), dhe 17 paragrafi 1, pika (b) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, Nr. 28/15, qershor 2008); nenet 13 paragrafi 1 pika 1.4, dhe 18 paragrafi 1, pika 1.2, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr.02-060/01-0056607/20-4, të dt. 24.09.2020; Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 11.09.2025 pasi shqyrtoi Propozim Vendimin e Kryetarit të Komunës Nr. 02-060/01-0050486/25, dt. 19.08.2025 si dhe duke vepruar sipas Shkresës së Ministrisë së Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Nr.prot.5769-2/25, datë 14.08.2025, sjell këtë:

VENDIM

Për plotësim dhe ndryshim të vendimit të Kuvendit të Komunës

Nr. 02-060/01-00216592/25, të datës 28.04.2025

1. Me këtë Vendim plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. 02-060/01-0021659-2/25, të datës 28.04.2025.
2. Ndryshohet titulli i vendimit dhe teksti ekzistues fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim: **Për Miratimin e Hartës Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK)2025-2033**
3. Ndryshohet pika 1 (e parë) e vendimit dhe teksti ekzistues fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim: Miratohet Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut për periudhën tetë (8) vjeçare 2025-2033, si një dokument multisektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe projeksioneve të investimeve publike dhe private, për tërë territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut.
4. Të gjitha pikat tjera të vendimit Nr. 02-060/01-0021659-2/25, të datës 28.04.2025 mbesin të pa ndryshuara
5. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAPL

1 x 1 Arkivit

Kopje: Kryetarit të Komunës

Të gjitha drejtorive

Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA





KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Nr. 02-060/01-0021659-2/25, dt. 28.04.2025

Mitrovicë

Bazuar në nenet 11, 12, paragrafi 2, pika (d), dhe 17 paragrafi 1, pika (b) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28/15, qershor 2008); neni 5 paragrafi 1.2 pika 1.2.2 dhe nen i 6 paragrafi 1.2 pika 1.2.1, lidhur me nenin 10 paragrafi 2, pika 2.2, dhe nenet 11 dhe 16 të Ligjit Nr.04/L174 Për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.30/2013); bazuar në Udhëzimin Administrativ të MMPH Nr.24/2015, Mbi Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Hartës Zonale të Komunës; Udhëzimin Administrativ të MMPH Nr.08/2017, Për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor; nenet 13 paragrafi 1 pika 1.4, dhe 18 paragrafi 1, pika 1.2, të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr.02-060/01-0056607/20-4, të dt. 24.09.2020; në Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr.02-060/01-0022696/20-2, datë 24.04.2020 për Fillimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut, si dhe duke i marrë për bazë dy dokumente të Ministrisë përkatëse siç janë: Vendimi i MMPHI Nr. Prot.7770-2/22, datë 23.02.2023, për Pëlqim Mjedisor për Raportin për Vlerësim Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut, si dhe Vendimin e MMPHI Nr.prot.3949-2/24, datë 13.11.2024, Për dhënien e Pëlqimit për Miratim të Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut 2024-2032, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28.04.2025 me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0018905-1/25 dt. 04.04.2025) sjell këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK) 2024-2032

1. Miratohet Harta Zonale e Komunës së Mitrovicës së Jugut për periudhën tjetër (8) vjeçare 2024-2032, si një dokument multisektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe projeksioneve të investimeve publike dhe private, për tërë territorin e Komunës së Mitrovicës së Jugut.
2. Me Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut, përcaktohen kushtet zhvillimore dhe kushtet ndërtimore për zonat urbane dhe rurale, në kontekst të ndryshimeve të bëra me nevojat reale dhe mundësi për të arritur kushte optimale të rregullimit dhe ndërtimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut.
3. Harta Zonale e Komunës, do të mbulojë sipërfaqen e territorit të Komunës së Mitrovicës së Jugut prej: $S=331.km^2$ dhe do të përfshijë të gjitha Zonat Kadastrale brenda territorit të Komunës.
4. Me hyrjen në fuqi të Hartës Zonale të Komunës shfuqizohen të gjitha Planet Rregulluese Urbane.
5. Për zbatimin e këtij vendimi, do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm e Komunës së Mitrovicës së Jugut.
6. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Dorëzohet:

1 x 1 Kryesueses së Kuvendit

1 x 1 MAP

1 x 1 Arkiv

Kopje: Kryetarit të Komunës

Të gjitha drejtorive



Kryesuesja e Kuvendit

Vesa BROJA